

24  
D.V. M.P. ARKIVI  
Drejta No 135  
Fleta 10

M A R R E V E S H J E  
ndermjet

QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE QEVERISE  
SE FEDERATES RUSE PER NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TE  
INVESTIMEVE KAPITALE

Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe Qeveria e Federates  
Ruse te quajtura Pale Kontraktuese,

duke patur si qellim krijimin e kushteve te favorshme per  
realizimin e investimeve kapitale nga ana e investitoreve te  
njeres nga Palet Kontraktuese ne territorin e Pales tjeter  
Kontraktuese,

duke patur parasysh se nxitja dhe mbrojtja reciproke e  
investimeve kapitale te tilla do t'i sherbejne zhvillimit te  
bashkepunimit ekonomik - tregtar dhe tekniko - shkencor me  
leverdi te ndersjellte,

Rane dakort per sa vijon:

NENI 1

1. Ne kete Marreveshje:

a) termi "investitor" nenkupton cdo person fizik, qe eshte  
shtetas i Pales Kontraktuese dhe cdo person juridik i krijuar ne  
perputhje me legjislacionin e saj;

b) termi "investime kapitale" perfshin cdo lloj pasurie qe  
investitoret e njeres Pale Kontraktuese investojne ne territorin  
e Pales tjeter Kontraktuese ne perputhje me legjislacionin e saj,  
nder to:

- pasurite ( godinat, objektet, pajisjet dhe vlerat e tjera  
materiale ) dhe te drejtat e pasurise perkatese, duke perfshire  
te drejten e garancise;

- mjetet monetare, si dhe aksionet, depozitat dhe format e tjera te pjesemarrjes;

- te drejten e kerkeses ndaj mjeteve monetare, te cilat investohen per krijimin e vlerave ekonomike, ose ndaj sherbimeve qe permbajne vleren ekonomike;

- te drejten e autorit, te drejten e shpikjeve, te mostrave industriale, te markave te mallit ose te markave te sherbimeve, te emertimeve te firmave, si dhe teknologjise dhe know-how;

- te drejttat per realizimin e aktiviteteve ekonomike qe jepen ne baze te ligjit ose te traktatit, duke perfshire nder te tjera te drejttat per kerkime, nxjerrje dhe shfrytezim te burimeve natyrore;

c) termi " te ardhurat " nenkupton shumat e vjela si rezultat i investimeve kapitale sipas nenpikes "b" te pikes 1 te ketij neni, dhe nder te tjera ne formen e fitimit ( pjeses se fitimit ), te devidenteve, perqindjeve, shperblimeve per licencat dhe komisionet, te pagesave per ndihmat teknike dhe sherbimet teknike, si dhe sherbimet e tjera.

2. Kjo marreveshje vepron ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe ne territorin e Federates Ruse , veprimi i saj gjithashtu shtrihet brenda zones ekonomike ekskluzive dhe shelfit kontinental, mbi te cilat shteti perkates, ne perputhje me te drejten nderkombetare, ushtron te drejttat sovrane dhe juridiksionin.

## NENI 2

1. Secila nga Palet Kontraktuese do te nxise investitoret e Pales tjeter Kontraktuese per realizimin e investimeve kapitale ne territorin e saj dhe ne perputhje me legjislacionin e saj lejon investime kapitale te tilla.

2. Secila nga Palet Kontraktuese garanton ne perputhje me legjislacionin e saj mbrotjen juridike te plote dhe pa rezerva te investimeve kapitale te investitoreve te Pales tjeter Kontraktuese.

### NENI 3

1. Secila nga Palet Kontraktuese do te siguroje ne territorin e saj per investimet kapitale te investitoreve te Pales tjeter Kontraktuese dhe per veprimtarine lidhur me investimet kapitale nje rregjim te drejte dhe te barabarte, qe perjashton perdorimin e masave me karakter diskriminues, te cilat mund te pengonin drejtimin dhe administrimin e investimeve kapitale.

2. Regjimi i permendur ne piken 1 te ketij neni, do te jete jo me pak i favorshem, se sa regjimi qe ju akordohet investimeve kapitale ose veprimtarise lidhur me investimet kapitale te investitoreve te vet ose te investitoreve te ndonje shteti te trete.

3. Secila nga Palet Kontraktuese ka te drejte te percaktoje degjet dhe sferat e veprimtarise, ne te cilat perjashtohet ose kufizohet veprimtaria e investitoreve te huaj.

4. Regjimi i kombit me te favorizuar, qe jepet konform pikes 2 te ketij neni, nuk do te shtrihet ne preferencat, te cilat Pala Kontraktuese i jep ose do t'i jape ne te ardhmen:

- ne lidhje me pjesemarrjen ne zonen e tregtise se lire, ne bashkimin doganor ose ekonomik;

- si rrjedhoje e marreveshjeve te Federates Ruse me shtetet qe me pare benin pjese ne perberjen e Bashkimit te Republikave Socialiste;

- ne baze te marreveshjes per eleminim e tatimeve te dyfishta ose te marreveshjeve te tjera per problemet tatimore.

MPJ ARKIVI  
Viti: (11)  
Dosja: (11)  
Fleta: 1

## NENI 4

Investimet kapitale te bera nga investitoret e njerës Pale Kontraktese ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese nuk do te shtetezohen ose t'u nenshtrohen masave te barazvlefshme me pasojat e shtetezimit (me poshte do te quhen "shtetezim"), me perjashtim te rasteve kur masa te tilla merren per interesa shoqerore, ne perputhje me procedurat e caktuara nga legjislacioni, nuk jane diskriminuese dhe shoqerohen me dhenien e kompensimit te menjehershëm adekuat dhe efektiv. Ky kompensim do te jete i barabarte me vleften reale te investimeve kapitale te shtetezuara drejt per drejt perpara momentit kur zyrtarisht eshte bere i njohur zbatimi faktik ose shtetezimi i ardhshëm. Kompensimi do te paguhet pa vonese te paarsyeshme ne valute te lire te konvertueshme dhe do te transferohet lirisht nga territori i njerës Pale Kontraktuese ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese. Deri ne momentin e shlyerjes, shumes se kompensimit do t'i llogariten interesat sipas perqindjes se tarifës te asaj Pale Kontraktuese, ne territorin e se ciles realizohen investimet kapitale.

## NENI 5

Secila nga Palet Kontraktuese i garanton investitoreve te Pales tjeter Kontraktuese, pas pageses prej tyre te tatimeve dhe taksave perkatese, transferimi pa pengesa jasht shtetit te pagesave ne lidhje me investimet kapitale, dhe nder to:

- a) te ardhurat, sic jane percaktuar ne nenpiken "c" te pikes 1, neni 1 i kesaj Marreveshjeje;
- b) shumat e paguara per shlyerjen e huave, te pranuar nga te dy Palet Kontraktuese si investime kapitale;
- c) shumat e marra nga investitoret ne lidhje me likuidimin e pjesshem ose te plote apo me shitjen e investimeve kapitale;
- d) kompensimi, i parashikuar ne nenin 4 te kesaj Marreveshjeje.

## NENI 6

Mosmarrevshjet ndermjet njerës nga Palet Kontraktuese dhe investitorit te Pales tjeter Kontraktuese, te lindura ne lidhje me zbatimin e investimeve kapitale, nder te tjera mosmarrevshjet per problemet e permasave, kushteve ose menyres se pageses se kompensimit, do te zgjidhen, sipas mundesise, ne rrugen e bisedimeve.

Ne rast se ne kete menyre mosmarrevshjet nuk do te zgjidhen brenda gjashte muajve nga momenti i lindjes se tyre, shqyrtimi i tyre mund te kalohet ne:

a) gjykatën kompetente ose ne arbitrazhin e Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles jane realizuar investimet kapitale;

b) Institutin e Arbitrazhit te Dhomes se tregetise te Stokholmit;

c) gjykatën e trete ad hoc ne perputhje me Rregulloren e Arbitrazhit te Komisionit te Organizates se Kombeve te Bashkuara per te drejten e tregtise nderkombetare (UNCITRAL).

## NENI 7

Palet Kontraktuese sipas propozimeve te seciles prej tyre mund te bejne konsultime per problemet qe kane lidhje me interpretimin ose perdorimin e kesaj Marrevshjeje.

## NENI 8

1. Mosmarrevshjet ndermjet Paleve Kontraktuese qe kane te bejne me interpretimin dhe perdorimin e kesaj Marrevshjeje do te zgjidhen me rrugen e bisedimeve.

Ne rast se ne kete menyre mosmarrevshja nuk do te zgjidhet, atehere, sipas kerkeses se njerës nga Palet Kontraktuese, ajo do t'i kaloje per t'u shqyrtuar ne nje gjykate te trete.

2. Gjykata e trete krijohet ne menyre te vecante per cfaredo rasti konkret. Palet Kontraktuese caktojne nga nje anetar gjykate, si dhe se bashku nje qytetar te vendit te trete ne cilesine e kryetarit te gjykates. Anetaret e gjykates duhet te caktohen brenda dy muajve, ndersa kryetari i gjykates brenda tre muajve nga momenti, kur njera nga Palet Kontraktuese do te deklaroje per synimin e kalimit te mosmarreveshjes per shqyrtimin ne gjykatën e trete.

3. Ne rast se afatet e percaktuara ne piken 2 te ketij neni nuk do te zbatohen, ne mungese te nje marreveshjeje tjeter, secila nga Palet Kontraktuese mund t'i drejtohet Sekretarit te Pergjithshem te OKB-se me kerkesen qe te beje emerimet e nevojshme.

4. Gjykata e trete merr vendim me shumice votash. Ky vendim ka force te detyrueshme. Secila nga Palet Kontraktuese perballon shpenzimet qe kane lidhje me veprimtarine e gjyqtarit te caktuar nga ajo; shpenzimet qe kane lidhje me veprimtarine e kryetarit te gjykates, si dhe shpenzimet e tjera Palet Kontraktuese i perballojne ne menyre te barabarte. Per te gjitha ceshtjet e tjera gjykata e trete percakton rregullin e punes se vet ne menyre te pavarur.

#### NENI 9

Kjo Marreveshje do te zbatohet per te gjitha investimet kapitale te bera nga investitoret e njerës Pale Kontraktuese ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese duke filluar nga data 1 janar 1995

#### NENI 10

1. Kjo Marreveshje hyn ne fuqi nga data e njoftimit te fundit me shkrim per kryrjen nga Palet Kontraktuese te procedurave te brendshme shteterore.

2. Kjo Marreveshje lidhet per nje afat prej 15 vjetesh. Veprimi i saj zgjatet automatikisht per afate te tjera 5 vjecare ne qofte se asnjera nga Palet Kontraktuse nuk do te njoftoje me shkrim Palen tjeter Kontraktuese jo me pak se 12 muaj perpara mbarimit te afatit perkates per deshiren e vet per nderprerjen e veprimit te kesaj Marreveshjeje.

3. Persa i perket investimeve kapitale te bera para dates se mbarimit te veprimit te kesaj Marreveshjeje, dispozitat e kesaj Marreveshjeje do te jene ne fuqi edhe per nje periudhe 15 vjecare pas kesaj date.

Bere ne Moske, me 11 prill 1995, ne dy ekzemplare, secili ne gjuhen shqipe dhe ruse, duke patue te dy tekstet te njejten vlere.

PER QEVERINE E REPUBLIKES  
SE SHQIPERISE



PER QEVERINE E FEDERATES  
RUSE

